



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE

ASAMBLEJA

Prot 660/14

Tiranë, më 20.10.2023

Vendim nr. 59 datë 20 tetor 2023  
Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë së Shkencave

Mbështetur neneve 8 e 11 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* dhe neneve 14, 15, 16, 17 e 18 të Statutit; sot, më datë 20.10.2023, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të saj, me rend dite të miratuar prej saj me vendimin e datës 11.9.2023.

Pasi u verifikua plotësimi i kuorumit sipas parashikimit në nenin 8 pika 4 të Ligjit nr. 53/2019 sipërcituar dhe në nenin 17 pika 2 të Statutit, dhe rezultoi se të pranishëm fizikisht në mbledhje janë 44 anëtarë, si dhe me votimin në distancë të 9 anëtarëve sipas nenit 10 pika 3 të Statutit; gjithësej 53 nga 54 anëtarë;

Pas ngritjes së komisionit të zgjedhjeve sipas nenit 17 pika 2 të Statutit dhe paraqitjes së relacionit të komisionit teknik;

Pasi konstatoi se dokumentacioni i nevojshëm, sipas parashikimeve në nenin 16 të Statutit, nga kandidati i regjistruar për konkurrim për funksionin e Kryetarit akad. Skënder Gjinushi është i plotë;

Pasi u njoh me platformën e drejtimit të Akademisë së Shkencave për katër vitet e ardhshme nga kandidati i regjistruar për konkurrim për funksionin e Kryetarit akad. Skënder Gjinushi;

Pas kryerjes së procesit të zgjedhjeve me votim të fshehtë e shpalljes së rezultatit nga komisioni i zgjedhjeve, sipas procesverbalit bashkëngjitur;

Vendosi:

1. Zgjedhjen e akad. Skënder Gjinushit në detyrën e Kryetarit të Akademisë së Shkencave për katër vitet e ardhshme, me 51 vota pro, 2 kundër dhe asnjë abstenim;

2. Në pajtim me nenin 92 pika 2 të Kushtetutës, vendimi i Asamblesë t'i dërgohet menjëherë institucionit të Presidentit të Republikës;

3. Ky vendim hyn në fuqi në përputhje me kalendarin e parashikuar në nenin 19 të Statutit të Akademisë së Shkencave.

**Shaban Sinani**

**Sekretar shkencor**

